

**VENDIM**  
**Nr. 685, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 169, DATË 17.3.2021, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR**  
**FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE TË ISH-REPARTIT**  
**‘RENEA’, DREJTORIA E FORCËS SË POSAÇME OPERACIONALE, LINZË,**  
**BASHKIA TIRANË, DHE CAKTIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË**  
**POLICISË SË SHTETIT SI NJËSI ZBATUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 169, datë 17.3.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i shtohet fondi në masën 131 876 398 (njëqind e tridhjetë e një milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të objekteve të ish-repartit “RENEA”, Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale, Linzë, Bashkia Tiranë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**